



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Procesverbalit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari Nr.12-320-53959 të datës 14.10.2019, duke vendosur sipas kërkesës së Asllan Zenelit nga Mirena të datës 08.08.2019, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE**

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1000 € (njëmijë euro), Asllan Zenelit nga Mirena, sipas kërkesës së tij të datës 08.08.2019 për ta mbështetur financiarisht dhe kompenzuar njëkohësisht për dëmin e shkaktuar nga ngordhja e dy lopëve qumështore konform Procesverbalit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari Nr.12-320-53959 të datës 14.10.2019.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në xhirollogarinë bankare XK051401000013980110 në Bankën Ekonomike.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjellë dëshmi-faturë dhe të njëjtat ti dorëzojë në Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Asllan Zeneli nga Mirena.

1Nr. 320-53959
Lipjan, më 14.05.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

